

Master Profesional në Drejtësi, *profili* “E Drejtë Biznesi”

Programi i masterit profesional “E drejtë biznesi” me kohëzgjatje 1-vjeçare është një program që mundëson zgjerimin e dijeve në fushën e legjislacionit tregtar, vendas dhe evropian, duke i mëshuar aspekteve praktike të mësimnxënies në këtë fushë. Programi ofron një shumëllojshmëri lëndësh nga fusha e të drejtës së biznesit, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë, përgatisin dhe kualifikojnë specialistë për ushtrimin e përgjegjësi dhe kompetencave në drejtim të: përvetësimit të teknikave të hartimit të kontratave tregtare, hartimit të dokumenteve të themelimit të shoqërive tregtare dhe këshillimit të vazhdueshëm për organizimin dhe drejtimin e shoqërive tregtare, këshillimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë ndërmjetësimi dhe arbitrazhi, rritjes së kapaciteteve për të identifikuar dhe gjetur burimet e financimit të sektorit të biznesit, përmes rrugëve tradicionale dhe atyre më moderne, etj.


Kurrikula

- o E Drejtë e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit ndërkombëtar tregtar;
- o E Drejta e Shoqërive Tregtare;
- o Metodat e Kërkimit Shkencor;
- o E Drejta e Konkurrencës;
- o E Drejta Tatimore dhe Doganore.

Karriera

Mundësi punësimi në:

- o Shoqëri dhe kompani tregtare vendase dhe ndërkombëtare;
- o Banka, sigurime dhe organe financiare;
- o Zyra avokatie dhe ndërmjetësimi;
- o Zyra Përmbartimi apo Këshillimi Juridik.



Kohëzgjatja & Forma e studimit

Studime me kohë të plotë

Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **1 vit akademik.**

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **2 vite akademikë**

Kriteret

- o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
- o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehësuar nga MASR/QSHA.

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehsuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UniBa.



Kontakte të departamentit:

☎ +355 68 20 85 434

✉ law.co@umb.edu.al | e.lloha@umb.edu.al